



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Tiranë, më 08.04.2020

NJOFTIM
PËR SHTYRJE TË AFATIT KOHOR PËR DORËZIMIN DHE HAPJEN E OFERTAVE

“Për procedurën e prokurimit, “Procedurë e Kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” me objekt: “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”

Për:

- **Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: ”KAP-KO d.o.o” + “ODJECA d.o.o” + “GALKO d.o.o” + “JELEN PROFESSIONAL d.o.o” + “GALEB d.d” + “OPENTECH CONSULTING & SERVICES SHPK”;**
- **Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: ”D&E SHPK” + “SUMMER CONF. s.r.l” + “LOVERS s.r.l” + “YAKUPOGLU TEKSTIL VE DERI SAN. TIC. AS A. VEDAT YAKUPOGLU”;**
- **Genç Taahhüt Giyim Tekstil İnşaat San. Ve Tic. Ltd. Sti.**

Në mbështetje të nenit 1, nenit 42 pika 2, nenit 43 pika 3 të Ligjit nr.9643/2016, i ndryshuar, në VKM Nr.243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” (publikuar në FZ nr.48 datë 24.03.2020), Agjencia e Blerjeve të Përqendruara shtyn afatin e fundit të dorëzimit dhe hapjes së ofertave për Fazën II, të procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”, Procedurë e Kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar, me REF-31606-07-25-2019, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së kandidatëve të kualifikuar në këtë procedurë prokurimi, nxitjen e konkurrencës ndërmjet tyre, sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë kandidatët.

Sqarojmë se, 2 (dy) nga kandidatët e huaj të kualifikuar për Fazën II, kanë paraqitur kërkesa për shtyrje të afatit të dorëzimit dhe hapjes së ofertave për Fazën II, të argumentuara me masat kufizuese, ndaluese dhe shtrënguese, të vendosura për shkak të situatës së shkaktuar nga përhapja e pandemisë COVID-19, jo vetëm në shtetet ku kandidatët e huaj ushtrojnë aktivitetin, por edhe në vende të tjera të BE-së e më gjerë, të cilat prej disa javësh e kanë bërë të pamundur përgatitjen e ofertës teknike (pamundësia e marrjes së dokumentacionit nga institucionet shtetërore dhe laboratorët e analizës, pamundësia e përgatitjes së mostrave të mallrave që kërkohen të prokurohen, pamundësia e paraqitjes fizikisht të përfaqësuesve të kandidatëve gjatë dorëzimit dhe hapjes së ofertave, etj), e për rrjedhim është bërë i pamundur dorëzimi i ofertës teknike në afatin e përcaktuar në Ftesën për Ofertë.

Përsa më sipër, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara njofton të gjithë kandidatët e kualifikuar nga Faza I - Parakualifikimi, të ftuar për të marrë pjesë në Fazën II - Oferta Teknike, si dhe të gjithë të interesuarit se, afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e ofertave për Fazën II të procedurës së

prokurimit me objekt: “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”, Procedurë e Kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar, Prokurim Elektronik, nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjes kuadër 4 (katër) vite, me REF-31606-07-25-2019, **shtyhet dhe ndryshon si vijon:**

Afati kohor për dorëzimin e ofertave është:

Data: 11/05/2020 (dd/mm/vvvv) , Ora: 11:00

Adresa : www.app.gov.al , Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, Sheshi Skënderbej, nr.3, Tiranë.

Afati kohor për hapjen e ofertave është:

Data: 11/05/2020 (dd/mm/vvvv), Ora: 11:00

Adresa : www.app.gov.al, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, Sheshi Skënderbej, nr.3, Tiranë.

